

VENDIM
Nr. 97, datë 2.4.2026

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” SHPK, DEGA NË TIRANË, PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGJINËS

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të nenit 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës me nr. 725/2 prot., datë 1.4.2026, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Future Energy Trading and Exchange Dynamics’ sh.p.k., dega në Tiranë, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë:

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 118, datë 24.5.2025, ka miratuar njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike me nr. ZRRE/LI_72/21, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1400_2021, datë 2.9.2021, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. (Fuente Dynamics)”, që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë. Njohja e licencës është e vlefshme deri më 1.9.2026.

- Gjithashtu, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 4.7.2023, ka miratuar njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/Li_55/16, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1734_2023, datë 5.5.2023, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë. Njohja e licencës është e vlefshme deri më 12.4.2028.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë, me anë të email-it datë 30.3.2026, protokolluar në ERE me nr. 725/1 prot. datë 30.3.2026, ka paraqitur në ERE kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në përputhje me nenin 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024.

- Shoqëria ka përcjellë të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, pikën 4.1, duke specifikuar të dhënat identifikuese.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjister elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për hapjen e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, si furnizues/tregtar i energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, për tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë, lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti